



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr. 474/15 prot.

Tiranë, më 16.12.2022

VENDIM

Nr. 930, Datë 16.12.2022

**“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË MBI RISHIKIMIN E PIKËS 6 TË
NENIT 85 TË LIGJIT NR. 43, DATË 30.04.2015 “PËR SEKTORIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE””**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.12.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për dhënie e disa rekomandimeve Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë mbi rishikimin e pikës 6 të nenit 85 të ligjit nr. 43, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrja ERZENI SHPK dhe GJIROFARMA SHA me anë të shkresës nr. 91 prot, datë 05.07.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 474 prot. 12.07.2022), dhe shkresës nr. 107 prot, datë 01.08.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 474/1 prot. 03.08.2022) kanë depozituar ankesën lidhur me problematikat e bizneseve që operojnë në tregun e grumbullimit dhe përpunimit të qumështit të lidhura në nivel tensioni 35 kv.
2. Ndërmarrjet ERZENI SHPK dhe GJIROFARMA SHA nëpërmjet kësaj ankese janë shprehur se në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si subjekte të lidhura në nivel tensioni 35 kv, dolën në treg të lirë duke siguruar energjinë e nevojshme nga furnizues të licencuar të energjisë elektrike.
3. Sipas këtyre ndërmarrjeve, në tregun energjitik jo të gjithë pjesëmarrësit e tregut i nënshtrohen të njëjta parimeve të përgjithshme dhe pavarësisht parashikimeve të ligjit për sektorin e energjisë elektrike nër dalien gradualisht në treg të lirë. aktualisht vetëm klientët

të cilët janë të lidhur në nivel tensioni 10 kv dhe 20 kv, faturohen me çmim më të ulët pasi përfitojnë prej shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike me çmime të reduktuara.

4. Në vijim të ankesës, ndërmarrjet ERZENI SHPK dhe GJIROFARMA SHA nëpërmjet shkresës nr. 474/2 prot., datë 13.9.2022, u ftuan nga Autoriteti i Konkurrencës në një takim konsultativ në datën 27.09.2022, për të diskutuar mbi problematikat e furnizimit me energji elektrike në nivel tensioni 35 kv.
5. Ndërmarrjet ERZENI SHPK dhe GJIROFARMA SHA në takimin konsultativ, ngritën përsëri shqetësimin me faktin se në tregun e grumbullimit dhe përpunimit të qumështit, janë rreth 60 operatorë të cilët furnizohen tek Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA, me çmim më të ulët energjie sesa ERZENI dhe GJIROFARMA të cilët e blejnë atë në treg të lirë. Për rrjedhojë, kostot e tyre rezultojnë të jenë më të larta për produktin fundor, si rrjedhojë çmimi për produktin është më i lartë, duke mos pasur kështu mundësi për të konkurruar me operatorët e tjerë.
6. Për këtë arsye, ankuesit kërkuan ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës, në mënyrë që Enti Rregullator i Energjisë të vërë gjithë operatorët e tregut në kushte të barabarta, që tregu të jetë i balancuar deri në momentin që gjithë operatorët të dalin në treg të lirë për blerjen e energjisë.
7. Ligji nr. 43, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, (Ligji nr. 43/2015) ka për qëllim garantimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë së shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.
8. Referuar pikës 1 të nenit 109 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, klientët e energjisë elektrike me tension 110 kv e sipër, si dhe çdo klient tjetër që, pavarësisht nivelit të tensionit të rrjetit të energjisë elektrike, në të cilin është lidhur, ka një konsum vjetor të energjisë elektrike më të madhe se 50 milionë kWh, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, konsiderohet se kanë dalë në treg të liberalizuar. Klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kv janë të detyruar të dalin në tregun e liberalizuar jo më vonë se data 30 qershor 2016, klientët e lidhur në tension 20 kv, jo më vonë se data 31 dhjetor 2016, ndërsa klientët e lidhur në nivelin e tensionit 10 kv dhe 0,6 kv, jo më vonë se data 31 dhjetor 2017. Klientët e lidhur në tension 0,4 kv kanë të drejtë të zgjedhin lirisht furnizuesin e tyre.
9. Detyrimi ligjor i të gjithë klientëve është që të dalin në treg të liberalizuar. Pavarësisht afateve ligjore të tejkaluara, për shkak të mosplotësimin të kushteve tekniko-ligjore dhe për arsye të cilat nuk janë të varura prej tyre, gjatë kësaj periudhe, çdo subjekt i cili ka dalë në treg të lirë, ka përfituar tarifa më të ulëta se tregu i rregulluar, fakt i konstatuar nga AK si palë e ftuar në mbledhjet e organizuara pranë ERE, ku klientët 20/10/0.6 kv operues në treg, kanë kërkuar vazhdimisht daljen në treg të lirë. Deri më tani, ky proces ka qenë i pamundur për shkak se ende nuk kanë qenë implementuar matësat smart, gjithashtu dhe për shkak të mungesës të “standard load profiles”. Nga data 1 janar 2022, OSHEE Group ka njoftuar për plotësimin e kushteve teknike të instalimit të sistemit të matjes për daljen në treg të liberalizuar.

10. Problematika në rrethanat aktuale qëndron në faktin se çmimi i energjisë në tregun e rregulluar është shumë herë më i ulët se në tregun e lirë, duke lejuar kështu që ndërmarrjet të cilat nuk kanë dalë ende në treg të lirë, të kenë kosto energjitike më të ulëta se ndërmarrjet të cilat kanë dalë nga tregu i rregulluar.
11. Në lidhje me këtë çështje, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përmes deklaratës së datës 22.12.2021¹, shprehet në kushtet e detyrimeve ligjore për liberalizimin e tregut të energjisë, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe angazhimeve të marra në kuadër të përafritimit me legjislacionin e BE, e konkretisht me Direktivën 2009/72/KE, duke mirëkuptuar situatën e krijuar për shkak të krizës globale energjitike, si dhe duke vlerësuar rëndësinë e zhvillimit të biznesit në funksion të rritjes së qëndrueshme ekonomike të vendit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të analizojë të gjitha kërkesat e tyre, për të pasur një qasje pozitive për mbështetjen e bizneseve prodhuese në këtë moment të vështirë.
12. Në datën 05.12.2022 pranë ambienteve të Autoritetit të Konkurrencës, u organizua një takim konsultativ, me palë të ftuar ERE, përmes shkresës nr. 474/12 datë 22.11.2022. Gjatë këtij takimi u diskutua në lidhje me kushtet aktuale të tregut dhe mënyrën e organizimit të tij, dhe rastet hipotetike se si mund të jepej një zgjidhje në lidhje me ankesën e subjekteve ERZENI dhe GJIROFARMA referuar shkresës nr. 474 prot., datë 12.07.2022.
13. Ajo çfarë u konsiderua e rëndësishme prej përfaqësuesve të ERE, qëndronte në faktin se në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” në nenin 86, pika 6, parashikohet se klienti fundor që furnizohet nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe që në kuptim të nenit 109, të këtij ligji, del për herë të parë në treg të liberalizuar, është i detyruar të lidhë një kontratë furnizimi me një furnizues të ri, brenda 2 viteve nga fillimi i kontratës së furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit.
14. Në përfundim të kësaj periudhe, operatori i sistemit ndërpret furnizimin me energji elektrike të këtij klienti. Për qëllime të përcaktimit të fillimit të afatit, sipas kësaj dispozite, llogaritja e afateve fillon nga e nesërmja e ditës kur operatori i rrjetit njofton klientin, në përputhje me parashikimet e nenit 109, të këtij ligj, për plotësimin e kushteve teknike të instalimit të sistemit të matjes për daljen në treg të liberalizuar.
15. Pra, çdo subjekt i ri i cili del në treg të lirë për herë të parë, ka një afat dy vjeçar në të cilin furnizohet me çmim të rregulluar nga FMF. Ky afat, sipas këtij neni nuk fillon nga momenti i plotësimit të kushteve të tregut nga OSHEE në 1 Janar 2022, por fillon nga dalja e subjektit në treg të liberalizuar. Kështu, kemi një pabarazi në trajtimin e subjekteve sipas vjetërsisë së daljes në treg, ku për një subjekt të ri që hyn në treg do të ketë kosto më të ulëta prodhimi për 2 vitet në vijim, sesa një tjetër i cili operon prej vitesh.
16. Afati 2 (dy) vjeçar i parashikuar prej OSHEE për plotësimin e kushteve teknike përfundon në 1 janar 2024, por zbatohet vetëm për ato subjekte të cilat kanë qenë duke operuar me energji të siguruar në treg të rregulluar në momentin e plotësimit të kushteve teknike të instalimit të sistemit të matjes për daljen në treg të liberalizuar në janar 2022.

¹ <https://www.infrastruktura.gov.al/deklarate-per-media-5/>

17. Për sa më sipër, Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjin për sektorin e gazit natyror.
18. Në kuadër të nenit 18 të këtij ligji, si institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit në Shqipëri, ERE ka për objektiva sigurimin e kushteve të duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë elektrike, angazhimin në zhvillimin e një sistemi të sigurt, të qëndrueshëm, jo diskriminues dhe në mbrojtje të konsumatorit, si dhe sigurimin e përfitimit të klientëve prej funksionimit të tregut të brendshëm, duke promovuar konkurrencën dhe mbrojtjen e klientëve. Gjithashtu në bazë të nenit 4 pika 2 të ligjit nr. 43/2015, ministria përgjegjëse për energjinë mbikëqyr zbatimin e politikave dhe programeve të zhvillimit të sektorit energjetik, në përputhje me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.
19. Aktualisht qëndrojmë para faktit ku çmimi i energjisë në tregun e rregulluar është shumë herë me i ulët se në tregun e lirë, duke lejuar kështu që ndërmarrjet të cilat nuk kanë dalë ende në treg të lirë, të kenë kosto energjitike më të ulëta se ndërmarrjet të cilat kanë dalë nga tregu i rregulluar. Kjo situatë është krijuar për shkak të parashikimeve ligjore të cilat kanë lejuar operimin e tregut në kushte të pabarabarta, të cilat janë vënë në dukje me daljen e subjekteve në treg të lirë.

PËR KËTO ARSYE:





Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe (f); neni 26; nenin 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë marrjen e iniciativës ligjore për rishikimin e pikës 6 të nenit 85 të ligjit nr. 43, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA  Zv/Kryetar	Rezana KONOMI  Anëtar	Adriana BERBERI  Anëtar	Durim KRAJA  Anëtar
---	---	--	---

